

Thoma Kacori

BIBLIOTEKA

8JH-1

K 13



FABULA

814-1
K13

Thoma Kacori

FABULA



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor
THOMA GËLLÇI

Kopertina
JUSUF SHAHINI

Ilustrimet
BARDHYL FICO

Recenzues
Gjikhë Luritiqi

LIBRARIA BOTUEN - NAIM FRASHËRI



URITHI DHE LULET

Urithi doli mbi tokë
në një kopsht të blerë
dhe u ndal.
të marrë pak erë.
I hedh sytë përreth
dhe veç lule sheh.
Aty trëndafilë
të kuq pors i gjaku,
më tej karafilë
dhe lule zambaku.

*E bukur ish dita,
shkëlqente si drita!
Dhe si gjithçka pa
hyri nga doli dhe tha:
— Si rrojnë këto të shkreta
e si s'u mërzitet jeta,
që kanë rënë
në këtë dritë,
që verbon sytë!*



RRODHES

Rrodhe, rrodhe kokorrodhe,
në djall të vesh ku u ndodhe!
Ja, u ngjite,
dhe nuk shqitesh,
Rrodhe gjen nën çdo drizë,
po re — ta çjerrin kurrizë.
T'u qep rrodhja në çorapë,
s'e shkëput njeriu dot prapë.
O moj rrodhe kokorrodhe,
këtë bezdi ku e vodhe?
Përgjigjet rrodhja e ferrës:
— Si unë ka plot edhe njerëz! . . .

FRASHËRI DHE THANA

Në një pyll u ndodhën pranë
një frashër edhe një thanë.

Të gjithë sa vinin aty
veç thanën kishin në sy.

Shkonin fshatarë — prisnin hostenë,
pleq për bastunë — kastile venë,
edhe fëmijët rehat s'e linin,

shkonin thanën e shkopinj prinin.

Lëvdohej thana dhe qesëndiste
frashërin e gjorë që për gjë s'ishte.


Por një ditë vjen një bari,
që ku s'e kish kërkuar,
e pa dhe me dashuri,

Preu një degë i gëzuar,
pastaj u ul nën hije

dhe filloi me zell ta gdhendë,
hem e gdhend dhe hem i bie,
sa tingujt u bënë kënoë.

Kur mbetën prapë të dy,
frashëri i tha në sy:

— Dhe për mua kanë nevojë,
por kush di të më punojë!



FSHATARI DHE DHELPRA

Zonja dhelpër me gëzof të artë,
që i ndriste qimja porsi qelibari,
e urët u fut një natë
te kotec' i një fshatari.

I rrëmbeu një pulë ndër dhjetë
dhe iku me vrap si shigjetë.

Fshatari u ndodh në dritare,
por pushkës s'ia hodhi sytë fare
lëkurën i pa
edhe tha:

— Me pulën ajo s'do rrijë,
nesër për zoga do vijë.
Më mirë ta zë të gjallë,
kush e di sa e shes vallë?!
E ruajti një ditë, dy, tre
por dhelpira s'u duk më për be
edhe sot vazhdon të rrojë!

QENI QË HARROI SHTËPINË E TIJ

Një fukara i këputur
kishte një qen,
të madh për dhen,
fisnik e të bukur.
E kishte si shok,
kudo vinin tok,
në arë, në vreshtë,
në verë e në vjeshtë,
qenin merrte pas
e ndillte me gaz,
me mall e fërkonte,
se tepër e donte.
Nga sofrë s'e ndante,
i jepte të hante,
ku përshesh me dhallë,
ku copë të ngjyer,
aa ia kishte hallë,
por pa ia kursyer.
Por se si, s'e di
me një tjetër qen.
na zu miqësi.
I shkoi në bulok.
Aty gjeti tok
kocka dhe mish plot